



**AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**



**UNIVERSITETI POLITEKNIK
I TIRANËS**

Nr. 539 prot. Tiranë, më 18.11 2025

Nr. 3375 prot. Tiranë, më 18.11 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
ndërmjet
AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR
dhe
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Sot, me datë 18 / 11 2025 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Universitetit Politeknik i Tiranës (UPT) institucion publik i arsimit të lartë me adresë: Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht nga **Rекtori Prof. Dr. Akli FUNDO**, këtu e në vazhdim “UPT”

dhe

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), institucion publik qendror, me NIPT L31919452G dhe adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, 1010 Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **përfaqësuar nga Drejtor i Përgjithshëm Znj. Vilma TOMÇO**, këtu e në vazhdim “ASIG”

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “**Pala**” ose bashkërisht si “**Palët**”.

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.


Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të përcaktojë dhe formalizojë kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet palëve, duke synuar rritjen e efikasitetit të shkëmbimit të informacionit gjeohapësinor, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes përgatitjes së specialistëve të rinj në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit, përmirësimin e cilësisë së ekspertizës kërkimore dhe integrimin e saj në procesin mësimor, si dhe nxitjen e përdorimit të teknologjive bashkëkohore në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 2 Fusha e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjeje*, fushat e bashkëpunimit do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në, këto veprimtari kryesore:

1. **Shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor dhe burimeve njerëzore** për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe përgatitjes praktike të studentëve për tregun e punës, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit;
2. **Zbatimin e projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare**, përfshirë organizimin e përbashkët të konferencave, simpoziumeve, seminareve, kurseve, workshopeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit akademik e shkencor në fushën e gjeoinformacionit, duke shfrytëzuar infrastrukturën dhe hapësirat institucionale të palëve për zhvillimin e këtyre veprimtarive;
3. **Shkëmbimin e njohurive, literaturës profesionale, teksteve mësimore, botimeve universitare, materialeve dhe rezultateve kërkimore** të veprimtarive të përbashkëta, në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe mirëbesimit;
4. **Rrjetëzimin dhe shkëmbimin e ndërsjellë të stafit akademik dhe kërkimor** me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulave dhe punës kërkimore-shkencore në fushën e gjeoinformacionit;
5. **Zhvillimin e programeve për praktika profesionale dhe procesin mësimor të studentëve**, përfshirë pranimin e studentëve praktikantë sipas mundësive të krijuara nga ASIG dhe mbështetjen e udhëheqjes së përbashkët të projekteve kërkimore e disertacioneve të doktoraturave;



6. Pjesëmarrje e ndërsjellët në aktivitete akademike, profesionale dhe shkencore të organizuara nga palët, përfshirë organizimin e leksioneve të hapura dhe workshop-eve mbi tema bashkëkohore e inovative në fushën e gjeoinformacionit;
7. Zhvillimi i një komunikimi efektiv e të qëndrueshëm për koordinimin dhe realizimin e projekteve, iniciativave dhe veprimtarive me interes të përbashkët në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 3

Angazhimet dhe të Drejtat e Palëve

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve të përbashkëta, duke vënë në dispozicion kapacitetet e tyre njerëzore, teknike, shkencore dhe institucionale.
2. Në kuadër të realizimit të projekteve të përbashkëta në fushën e gjeoinformacionit, të dyja palët angazhohen zyrtarisht të vënë në dispozicion të dhëna si dhe informacione të tjera me interes reciprok me qëllim realizimin e iniciativave të përbashkëta, duke respektuar legjislacionin në fuqi.
3. Palët përcaktojnë në mënyrë të përbashkët numrin e studentëve pjesëmarrës në praktika, periudhën e zhvillimit, kohëzgjatjen dhe përmbajtjen orientuese të programeve përkatëse, duke respektuar kapacitetet organizative dhe objektivat mësimore të secilës palë.
4. ASIG angazhohet të mirëpresë studentët e përzgjedhur për zhvillimin e praktikës mësimore, t'i asistojë dhe trajnojë në përputhje me programet e miratuara, si dhe të sigurojë, kur kërkohet, vlerësime për ecurinë e tyre akademike dhe profesionale.
5. ASIG rezervon të drejtën të ndërpresë zhvillimin e praktikës, për individë të veçantë ose për të gjithë grupin, në rastet kur konstatohen shkelje të kushteve të dakortësuara ose sjellje që çenojnë mbarëvajtjen e punës institucionale. Vendimi për ndërprerjen bëhet në koordinim me UPT-në dhe me njoftim paraprak me shkrim.
6. UPT angazhohet të propozojë dhe përfshijë ASIG si partner në projektet kërkimore, akademike dhe inovative me interes të ndërsjelltë.
7. UPT angazhohet të informojë zyrtarisht ASIG-un për programin e praktikave mësimore, ta njohë atë si partner zyrtar në këtë proces dhe, kur është e nevojshme, të ofrojë asistencë për studentët në ambientet e ASIG-it para fillimit të praktikës.
8. UPT merr përsipër të vërë në dispozicion të ASIG-it rezultatet e punës kërkimore-shkencore të realizuara në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet palëve.
9. Palët angazhohen të kontribuojnë në mënyrë të ndërsjellë në përmirësimin e kapaciteteve të autoriteteve publike në fushën e menaxhimit të informacionit gjeohapësinor, nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve të përvojës dhe organizimeve të përbashkëta, në përputhje me misionin dhe kompetencat e tyre institucionale përkatëse.
10. UPT angazhohet të mbështesë ASIG në organizimin e workshop-eve, konferencave apo veprimtarive të tjera promovuese në fushën e gjeoinformacionit, duke vënë në dispozicion, sipas mundësive, ambientet dhe infrastrukturën akademike të saj.

11. UPT ka të drejtë të përzgjedhë studentët potencialë që do të kryejnë programin e praktikës mësimore pranë ASIG si dhe të marrë pjesë në proceset e monitorimit dhe të vlerësimit të studentëve kur kryejnë praktikatat mësimore.

Neni 4

Konfidencialiteti

1. Secila palë e kësaj Marrëveshjeje angazhohet të mos bëjë publike, të mos përhapë dhe të mos komunikojë tek palë të treta asnjë informacion, dokumentacion apo të dhënë të lidhur me veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo informacion tjetër që nuk është i njohur nga publiku në momentin e marrjes së tij ("Informacion Konfidencial"), përveç rasteve kur ekziston miratimi paraprak me shkrim i palës tjetër.
2. Secila palë angazhohet të përdorë Informacionin Konfidencial vetëm për qëllime që lidhen me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe për asnjë qëllim tjetër, personal ose institucional.
3. Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave sensitive dhe personale, si dhe të respektojnë privatësinë e informacionit të shkëmbyer gjatë bashkëpunimit, duke i administruar ato në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar.
4. Detyrimi i ndërsjellë për konfidencialitetin do të vazhdojë të mbetet në fuqi dhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje sipas parashikimit të nenit 5 të saj, ose për aq kohë sa informacioni nuk është bërë publik në mënyrë të ligjshme.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet pa afat të përcaktuar dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët, duke prodhuar efektet juridike përkatëse prej datës së nënshkrimit.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila do të ketë kompetencën përfundimtare për zgjidhjen e saj.



Neni 7

Njoftimet mes palëve

Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar ose me postë elektronike. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për Universitetin Politeknik të Tiranës:

Person Kontakti: Prof. Dr. Elfrida Shehu

E-mail: elfridashehu@upt.al

Për ASIG:

Person Kontakti: Dritan Domi, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm

E-mail: Dritan.Domi@asig.gov.al

Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme

1. Ndryshimet ose shtesat e pjesshme që do të bëhen kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.
2. Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore, nga një kopje për secilën palë.

PALËT

**AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



UNIVERSITETI POLITEKNIK

I TIRANËS

REKTORI

Prof. Dr. Akli FUNDO

